



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 681 Prot.

Tiranë, më datë 09.06.2022

VENDIM  
Nr. 236, datë 09.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.06.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Verifikimit në terren për gjetjet rastësore, dy varre me konstrukcion pllaka guri u zbuluan gjatë mirëmbajtjes së rrugës Dukagjin - Gjocaj - Lami i madh nga Bashkia Mat” hartuar nga IKTK;
2. Të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit nga IKTK për varret e periudhës mesjetare të zbuluara gjatë rehabilitimit të rrugës Dukagjin – Gjocaj,
3. Të realizohet vëzhgimi arkeologjik sipërfaqësor i zonës me qëllim përcaktimin e kufijve të shtrirjes së varrezës,
4. Objektet arkeologjike të zbuluara të regjistrohen pranë IKRTK-së
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

